

Press

Kuvendi i Lipjanit me këshilltarë të “pa gojë”

Daut Duriqi

Lipjan, 3 shkurt

Një pjesë e mirë e këshilltarëve komunalë të Lipjanit, në seancat e Kuvendit në gjashtëmuorin e dytë të vitit 2012, kanë praktikuar agjërimit në të folme, duke e kthyer veten vetëm në mekanizëm të votës, pa u deklaruar asnjëherë për ato që votuan. Të zgjedhurit e miletit, për 6 muajt e dytë të vitit 2012, kanë preferuar që përfaqësimin e atyre që i kanë votuar, ta kryejnë në heshtje, madje duke mos u deklaruar as për një çështje të vetme. Në vlerësimin që ka bërë nëpërmjet një fletënotimi Youth Association for Human Rights, ka vërejtur se gjatë kësaj periudhe nga 31 këshilltarë sa ka Kuvendi i Lipjanit, 12 prej tyre në nuk kanë diskutuar asnjëherë. Nga numri i 12 këshilltarëve të “pa gojë”, të cilët YAHR në raportin e vet i cilëson si deputetë “shikuesë”, shumica prej tyre janë femra (9). Ndërkq përkthyer në subjekte, YAHR ka vërejtur se numrin më të madh të këshilltarëve “shikues”, e jep subjekti që është më i madhi në përfaqësim PDK (5), e

pasuar nga LDK (4) dhe AKR (2) si dhe AAK (1). Bekim Krasniqi, drejtor ekzekutiv në YAHR, thotë se vlerësimet janë të bazuara në vëzhgimin e drejtpërdrejtë dhe objektiv të punimeve të Kuvendit Komunal të Lipjanit. “Monitoruesit e YAHR-it kanë përcjellë të gjitha seancat e Kuvendit të Komunës së Lipjanit gjatë periudhës Korrik - Nëntor 2012. Për më tepër, monitoruesit e YAHR-it kanë realizuar një numër të konsiderueshëm të takimeve individuale me shumë anëtarë”, thotë Krasniqi. Në fletënotimin e nxjerrë, YAHR në formë tabelare ka renditur këshilltarët aktivë dhe pasivë me pjesëmarrje në diskutime gjatë seancave, duke përmendur kontributin e secilit veq e veq. Deputetet më aktivë të kësaj periudhe, sipas fletënotimit, kanë qenë udhëheqësit e grupeve të partive politike në Kuvend. Sefer Tasholli LDK 7, Blerim Gashi AKR 6, Sylejmon Recica AAK 5, Mevlide Shamolli LDD 5, Fitim Selimi PDK 4, Ragip Mehmeti LDK 4, Alban Aslani AKR 4, Feti Krasniqi LDD 4, Mevlide Dulahu LDK 3, Rizah Qeriqi PSD 3, Heset Sahiti PDK 2, Bahtir Bahtiri PDK 2, Ilir Tasholli PDK 2, Naser Sopjani LDK 2, Zyfer Aliu 2,



Enver Kozhani PDK 1, Idriz Krasniqi PDK 1 dhe Muhamet Shabani LDK 1. Ndërkaq deputetët pasivë, të ashtuquajtur “shikues” të kuotuar nga YAHR me zero diskutim janë: Ajshe Olluri PDK, Sebahate Qeriqi PDK, Makfire Ilazi PDK, Hajrije Salihu PDK, PDK, Ramadan Grajqevci LDK, Faik Lekaj LDK, Vlora Limani LDK, Burbuqe Fazliu LDK, Albulena Gashi AKR, Lumturiye Bytyqi AKR, dhe Jalldyze Gashi AAK. YAHR gjithashtu si karakteristikë ka

vërejtur se në seancat e Kuvendit të mbajtura në periudhën korrik-dhjetor ka pasur mungesë të këshilltarëve në fillimin e punës së Kuvendit, por që megjithatë konstaton se ka pasur kuorum të mjaftueshëm, për të përmendur edhe nivelin e lartë të kulturës parlamentare të këshilltarëve, të cilët sipas YAHR, nuk kanë përdorur në asnjë rast gjuhë e cila do të ishte fyese për ndonjë anëtarë tjetër të këtij institucioni.